



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE
DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Nr. 695... Prot.

Tiranë, më 10.02.2025

NJOFTIM

PËR VEND PUNE

SPECIALIST I SEKTORIT TË PROVIMEVE DHE VLERËSIMEVE KOMBËTARE/NDËRKOMBËTARE, NË
DREJTORINË E VLERËSIMIT, PRANË QENDRËS SË SHËRBIMEVE ARSIMORE

Në mbështetje të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr., 1013, datë 10.12.2010, "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve", i ndryshuar dhe të Urdhrit të Kryeministrit nr.146, datë 28.09.2018, "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Provimeve", i ndryshuar, Qendra e Shërbimeve Arsimore njofton shpalljen e vendit të lirë të punës:

- Në pozicionin e specialistit në Sektorin e Provimeve dhe Vlerësimeve Kombëtare/Ndërkombëtare, në Drejtorinë e Vlerësimit. Ai/Ajo punon nën drejtimin e Përgjegjës të Sektorit, Drejtorit të Drejtorisë dhe Drejtorit të Përgjithshëm të QSHA-së, si pjesë e ekipeve të punës brenda institucionit dhe bashkëpunon me pjesëtarët e tjerë të stafit. Përgjegjësitë e pozicionit përfshijnë një gamë të gjerë të çështjeve të cilësisë në fushën e vlerësimit të arritjeve, të pranimit në shkollat e larta dhe të provimeve.
- Kualifikimet, aftësitë dhe eksperiencat që kërkohen për këtë vend pune janë:
 - ✓ Diplomë universitare. Diplomë master dhe studimet pasuniversitare përbëjnë avantazh.
 - ✓ Të ketë njohuri dhe aftësi shumë të mira gjuhësore dhe komunikimi në të shkruar dhe të folur. Të ketë njohuri mbi shkrimin akademik të gjuhës shqipe.
 - ✓ Të ketë njohuri dhe aftësi shumë të mira komunikimi në të shkruar dhe të folur në gjuhën Angleze. Njohuri në gjuhë të tjera të BE-së përbëjnë avantazh.
 - ✓ Të ketë njohje të mirë të legjislativës arsimor shqiptar dhe politikave të vlerësimeve arsimore dhe të strategjive të zbatimit të këtyre politikave.
 - ✓ Të ketë aftësi në përdorimin e programeve bazë kompjuterike.
 - ✓ Të ketë aftësi në përdorimin në mënyrë efektive të dhënave informatike. Formimi dhe aftësitë në fushën e informatikës përbëjnë avantazh.
 - ✓ Të ketë aftësi për të punuar në ekip dhe për të marrë iniciativë.
 - ✓ Të ketë aftësi për të punuar nën presion dhe me afate të ngushta kohore.
 - ✓ Të ketë aftësi të ndjekë dhe menaxhojë disa detyra në të njëjtën kohë.
 - ✓ Të punojë vazhdimisht për zgjerimin e njohurive shkencore, profesionale dhe menaxheriale në mënyrë të dokumentuar.
 - ✓ Të tregojë përkushtim ndaj misionit të institucionit.

Paga për pozicionin është në kategorinë IV-2.

Mundësi zhvillimi profesional i vijueshëm, trajnime profesionale kombëtare dhe ndërkombëtare.

3. Paraqitja e dokumenteve: Kandidati duhet të paraqesë brenda datës 24.02.2025 në sekretarinë e Qendrës së Shërbimeve Arsimore, me adresë, QSHA, Bulevardi Zhan D'Ark nr. 23, Tiranë, këto dokumente: Kërkesën për Aplikim, CV-në, fotokopje të noterizuar të diplomës dhe listës së notave, fotokopje të librezës së punës, fotokopje të certifikatave të kualifikimit si dëshmi të gjuhëve të huaja, kompjuterit, vërtetimit të gjendjes gjyqësore, raportin mjekësor për aftësinë në punë, të paktën një letër rekomandimi, një numër telefoni për t'u kontaktuar, si dhe adresën e plotë të vendqëndrimit.

Njoftimi për shpalljen e këtij vendi të lirë pune mund të gjendet edhe në faqen zyrtare të QSHA-së www.qsha.gov.al

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Aida MYRTO

